VENDIM
Nr. 258, datë 27.3.2020

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, MIRATUAR PËR VITIN 2020, PËR PAGESËN E KËSHILLTARIT FINANCIAR PËR MENAXHIMIN E BORXHIT SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin buxhetor "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme" 01130, i shtohet fondi prej 98 400 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë e katërqind mijë) lekësh, për pagesën e këshilltarit financiar për menaxhimin e borxhit shtetëror.
2. Efekti financiar, prej 98 400 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë e katërqind mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar për vitin 2020.
3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama